

Lojra aritmetike në shtëpi

për fëmijë të moshës 4-7 vjeç

«Garë kolone»



Një mënyrë e këndshme për të bërë të njohur tek fëmijët simbolet aritmetike

Mjetet: do të nevojiteni aq tabela (shih tabelat 1 & 2) sa dhe lojtarë dhe 2 zare.

Numri i lojtarëve: 2-5

Ushtrime-lojra
për prindër e
fëmijë

Tabela 1

1	2	3	4	5	6

Çdo lojtar ka një letër me 6 kolona dhe aq vija sa dëshiron (p.sh. 6x6, shih tabelën 1). Hidhni zarin dhe shikoni numrin përkatës që shënohet në anën e sipërme të tij, i cili bën që lojtari me këtë numër të fitojë të drejtën të mbushë i pari kolonat e tij. Gjithashtu loja mund të mbarojë në çdo kohë. Fitues është ai që mbush më shumë kutia. Ndërkohë mund të ketë edhe fitues për çdo kolonë, p.sh. fituesi i 5-ës është ai që ka mbushur më shumë kutia në kolonën e 5-të apo fituesi i 3-shit është ai që ka mbushur më shumë kutia në kolonën e 3-të, e.t.j.

Një variant tjetër: Më vonë përdorni tabelën 2 dhe luani me 2 zare. Mund t'u sygjeroni fëmijëve të bëjnë mbledhje apo dhe zbritje (vetëm nëse mendoni se janë gati për diçka të tillë), nëse është e nevojshme për të fituar.

Tabela 2

2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	

Ide aritmetike që përfshihen në lojë

- Përbërja e sasisë dhe e simboleve aritmetike
- Njohja e simboleve aritmetike
- Shkrimi i simboleve aritmetike
- Hyrja në veprimet aritmetike mbledhje e zbritje

Fëmijët e vegjël dhe simbolet aritmetike



Disa fëmijë njohin që shumë herët disa nga simbolet aritmetike. I takojnë në jetën e tyre të përditshme në vende të ndryshme; në ashensor, në faqet e librave, në makina, në autobusa, në të hollat, në çmimet e produkteve, e.t.j. Gjithashtu në ambientin shkollor përdoren shpesh. Ndërkohë, mund të vështirësohen në shkrimin e tyre.

Shpesh herë shkruajnë mbrapsht numrat, p.sh. 3-in e shkruajnë ε ose 4-ën sikur të shkruajnë simetrikun e tij. Është shumë e rëndësishme të kuptojnë fëmijët kuptimin e numrave, të identifikojnë kuptimin e tyre, por gjithashtu është shumë e rëndësishme të mund t'i përdorin kur u nevojiten, t'i njohin por dhe t'i shkruajnë. Kur duam, pra, të ndihmojmë fëmijët me qëllim që të mund të njohin dhe të shkruajnë numrat, nuk duhet të harrojmë se duhet ta bëjmë në një mënyrë që të ketë kuptim për ta dhe t'u interesojë. Disa lojra si: «Garë kolone», janë një mënyrë e këndshme për të ndihmuar fëmijët të njohin, të shkruajnë dhe të përdorin simbolet aritmetike.

Tips!

Kur fëmijët bëjnë "gabime" të ndryshme në të shkruarin e numrave; ngatërrojnë numrat me shkronjat, i shkruajnë mbrapsht e.t.j., është e rëndësishme të mos theksohen këta "gabime" të tyre. *Kur të vijë rradha juaj u tregoni thjesht si shkruani ju, p.sh. 3-shin.* Mos i dekurajoni duke u vënë në dukje vazhdimisht gabimet dhe kurrë mos ushtroni presion.

Argëtim të mbarë!



Enti zbatues

POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsimit dhe në Shoqëri



www.polydromo.gr
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti

Maria Papandreu, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Koordinatorë të programit

Birbili Maria – Cokalidhu Rula

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Email: mmpirmpi@nured.auth.gr
tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes

Valbona Hystuna

Përpunuan tekstin

Evi Marku

Me mbështetjen e

